

AKT THEMELIMI

SugarCode

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot, me date 26/11/2022, ne Lushnje, une Z. Fani Rrudha, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 24/01/1991, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal J11024024R, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruaj kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar SugarCode.

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaku themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjetere.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte SugarCode.

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e statutit dhe aktiti te themelimit.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

4.1 Veprimtaria e shoqerise SugarCode do te kete per objekt:

- zhvillimin e programeve kompjuterike dhe sherbimin per mirembajtjen e tyre per palet e treta brenda dhe jashte vendit

4.2 Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.

4.3 Shoqeria, me vendim te administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

4.4 Per te realizuar qellimet e saj, shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera, ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te ortakut.

Neni 5

Selia

Shoqeria SugarCode e ka seline ne adresen:

Mehallez, Ndertesa nr 3, Hytja 1, Gradishte, 9014, Divjake, Lushnje.

Ne kete adrese do te ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqerise.



Neni 6

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

Neni 7

Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke.

Kapitali do te ndahet ne nje kuote me vlere 100 leke.

Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqerise do te jete:

Znj. Renalda Zhuka, person me shtetesi shqiptare mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr personal J65903018A.

Afati i emerimit te administratorit eshte 5 vjecar per periudhen 26/11/2022-25/11/2027, me te drejte riemerimi.

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.



Neni 10

Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapital. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne pasqyrat dhe raportet financiare tec do viti financiar, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise, ose mund te rrinvestohen si kapital i shoqerise.

Neni 11

Juridiksioni

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre jane gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar SugarCode eshte hartuar ne 2 kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet nga ortaket themelues.

ORTAK I VETEM I SHOQERISE

SugarCode

FANI RRUDHA

